

Lezhë, më 16.02.2026

PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 16.02.2026, në orën 12:00, në sallën e këshillit bashkiak, në Pallatin e Kulturës Lezhë, mbi mbledhjen jashtë radhe të Këshillit të Bashkisë Lezhë, e thirrur me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë, z. Pjerin ndreu.

Mbledhja u hap nga kryetari z. Ndue Luli, i cili lexoi rendin e ditës.

-Ndue Luli: Përshëndetje të gjithëve. Faleminderit për pjesëmarrjen.

Sot kemi mbledhje jashtë radhe të Këshillit Bashkiak Lezhë, me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë, me rend dite:

1. Projekt-Vendim “Për miratimin në parim të projektit “Përmirësimi i banesave ekzistuese për familje” për vitin 2026”

Kush është dakord me rendin e ditës?

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë, 21 vota Pro.

Në lidhje me projekt vendimin do të na sqarojë drejtoresha e Shërbimit Social në Bashki.

-Marte Feta: Përshëndetje të gjithëve të nderuar anëtarë të këshillit bashkiak. Gjithmonë ju jemi mirënjohës për punën që bëni por sot më shumë se kurrë ju jam shumë mirënjohëse që keni zgjedhur të vini sot dhe të na dëgjoni ne mbi diçka që të ndihmohen 17 familje të komunitetit të Lezhës të cilat do i ndihmojmë për rikonstruksionin e banesave. Ne na ka ardhë një formular për të aplikuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë i cili kishte një kohë shumë të shkurtër, 2 javë, dhe menjëherë Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social ka përzgjedhur familjet, pasi dhe te aplikimi ishin të përcaktuara se cilat familje mund të aplikonin për të qenë pjesë e këtij projekti, ishin të përcaktuara: familje të ndihmës ekonomike, familje me anëtarë me aftësi të kufizuara, familje të komunitetit rom dhe egjiptian dhe familje me varfëri ekstreme. Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social ka zgjedhur 17 familje, dhe gjej rastin t'ju them këtu se kemi pasë një lapsus, në p/vendim e kemi shkruar 16 dhe te lista janë 17. Kemi 17 familje të cilat janë zgjedhur dhe janë bërë të gjitha dokumentat dhe pse me vështirësi sepse sistemi online i shërbimit social dhe e-albania nuk punonte çdo ditë. Këtyre famioljeve do u bëhet rikonstruksioni, pra ne do aplikojmë te ministria por duhej me doemos të vinim në këshillin bashkiak për të bërë aplikimin, sepse ishte një ndër kriteret. Vlen të theksohet që për drejtorinë tonë është shumë e rëndësishme që ta kemi si program në vazhdimësi, duke qenë se drejtoria jonë deri tani ka pasë vetëm dy programe, programin e kredive të buta dhe programin e bonusit të qerasë, por nëse ne aplikojmë dhe dalim fitues, do ta kemi dhe në vazhdimësi. Këto 17 familje janë zgjedhur nga komisioni i strehimit social. Ishte kusht që të gjithë t'i kenë banesat me dokumenta, me legalizim ose në proces legalizimi. Punonjësit e Shërbimit Social kanë qenë në kontakt me institucionet që t'i bashkëngjitin dokumentat për këto familje që uroj që pas këtyre 17 familjeve të zgjerohet projekti dhe me shumë familje të tjera për t'i ndihmuar. Është dhe bashkëfinancim nga Bashkia Lezhë. Nëse ka kush ndonjë pyetje...

-Erdhi këshilltari Erin Ndreca.

-Ndue Luli: Faleminderit. Kush ka diçka? Po zoti Jaku.

-Marko Jaku: Nuk kam asnjë vërejtje për çështjen e këtyre familjeve por për zonat e fshatrave pse nuk është futur asnjë?

-Marte Feta: Unë në fakt e shpjegova se koha ishte shumë e shkurtër. Kemi pasur vetëm 8 ditë pune në dispozicion për të bërë projektin dhe ishte e pamundur që të shpërndahehim në të gjitha njësitet administrative dhe komuniteti rom dhe egjiptian është një target grup që ka prioritet në të gjitha programet e Drejtorisë së Shërbimit dhe Kujdesit Social dhe ishte e përcaktuar: familja ose duhet të ketë person me aftësi të kufizuar, ose të jetë e ndihmës ekonomike, pra që do të thotë, ishin disa kriteret që duhej t'i plotësonin familjet. Unë e di që ka familje në njësitet administrative, por nëse ne do e fitojmë këtë projekt, atëherë do shkojmë me shtim për aplikime në njësitet administrative. Por pjesë të aplikimit për strehimin social ne kemi pasë vetëm familje të qytetit të cilat kanë pasë nevojë për rikonstruksion sepse këto edhe pse kishin banesën e vet vinin dhe aplikonin te strehimi për bonus qeraje por kushti thotë që nëse ti ke një banesë në dispozicion, nuk mund të përfitosh bonus qeraje. Dhe këto i kemi pasë të gjitha në sistem.

-Marko Jaku: Unë e kisha për një shpërndarje të barabartë. Ato familje a duhet të kishin aplikuar?

-Eueda Molla: Është edhe çështja e dokumentacionit sepse jo të gjithë e kanë çertifikatën e pronësisë të shtëpisë. Edhe afati kohor, në dt 23 ka ardhë në bashki.

-Erdhi këshilltari Klevis Bezhi.

-Marte Feta: Jo, nuk duhet të kishin aplikuar, por kishim numër të caktuar te sistemi jonë i strehimit social për një program, që të përfitonin. Dhe familjet te njësitet administrative nuk kanë qenë aplikuese te ne dhe për të vetmen arsye se ne si shërbim social nuk e kemi pasë këtë program më përpara. Patjetër që në vijim do të informohen.

-Eueda Molla: Ne sapo ta fitojmë këtë program, do fillojmë si në njësitet administrative, ashtu dhe në qytet, që ta aplikojmë, që t'i shtojmë këto familje dhe t'i kemi gati që në momentin që hapet thirrja dhe një herë, ne të aplikojmë jo me 17, por me 37.

-Ndue Luli: Faleminderit. Mendim tjetër? Po zoti Tonin.

-Tonin Jaku: Përshëndetje të gjithëve. Për familjet që janë në proces legalizimi, si do veprohet? Nëse nesër pasnesër nuk legalizohen, do shkojë bashkia do ua prishë?

-Marte Feta: Ishte si kriter, ose e kanë të legalizuar, ose janë në proces legalizimi. Ne kemi komunikuar me ASHK-në. Komuniteti rom-egjiptian e ka të pamundur të paguajë tarifën dhe ne, nëse shpallen fituese këto familje, do e paguajmë ne, bashkia, që të marrin dokumentin.

-Ndue Luli: Tjetër? Po zoti Marku.

-**Agostin Marku:** Znj. Marte shikoni te pika 2, sepse nuk ekziston me Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Është vetëm Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit. Të rregullohet. Është gjë pozitive të realizohet kjo sepse ne vijmë pastaj dhe për të tjerët, siç e tha dhe zv/kryetarja.

-**Ndue Luli:** Mendim tjetër? Nuk ka tjetër. Atëherë kush është dakord me këtë projekt vendim, duke u bërë ato ndryshimet teknike të vogla?

Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 23 vota Pro.

Ju falenderoj shumë për pjesëmarrjen dhe për angazhimin tuaj në këtë mbledhje jashtë radhe, që ishte shumë e domosdoshme dhe them që zbatimi i këtij projekti do të sjellë dhe të tjera pas. Mirupafshim në mbledhjen e radhës të muajit shkurt.

Shënim: Mbledhja u transmetua live në Facebook në faqen “Këshilli i Bashkisë Lezhë”.

SEKRETARI

Florida Çunaj
&

KRYETARI

NDUE LULI
